



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 246, Datë 13.12.2021

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN NËNTOR 2021**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me vendimet e bordit nr. 144, datë 25.06.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 03.09.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 13.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 151/5 prot., datë 10.12.2021, e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Nëntor 2021”,

Konstatohet se:

- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën e saj nr. 10315 prot., datë 01.12.2021, të protokolluar me tonën nr. 286/10 prot., datë 03.12.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin Nëntor 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Bazuar në kërkesën e FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit** bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021” është 0.75 lekë/kWh.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV** bazuar në vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, të bordit të ERE-s “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2021” është 1.5 lekë/kWh.

- Në zbatim të *Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit* të ndryshuar, llogaritjet e FSHU sh.a. si dhe përlllogaritjet e konsideruara nga ERE mbështetur në këtë aplikim për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF për muajin Nëntor 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Nëntor 2021			
Nëntor 2021		Sipas aplikimit të FSHU sh.a.	Sipas Përlllogaritjeve të ERE
		Njësia	Çmimi
CBEt	të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	33.679
Pr	<u>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)</u>	Leke/kWh	1.01
Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante		Leke/kWh	34.69
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA		Leke/kWh	38.73

- Bazuar në çdo element të formulës përlllogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikim, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Nëntor 2021, të jetë 38.73 Lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

- Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit 38.73 Lekë/kWh për muajin Nëntor 2021.
- Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI